

KOSOVË

INFRASTRUKTURA PËR UJËRA TË ZEZA NË FERIZAJ



Korniza për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës
(KBTRMJ)

Tetor 2023

Shënim: Ky dokument është një përkthim i origjinalit të shkruar në anglisht. Në rast të ndonjë paqartësie apo dyshimi, versioni në gjuhën angleze ka përparësi.

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

| | |
|--------|--|
| BERZH | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim |
| MS | Mjedisor dhe Social |
| PMS | Politika Mjedisore dhe Sociale |
| KBTRMJ | Korniza për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës |
| PBTRMJ | Plani për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës |
| NJZP | Njësia e Zbatimit të Projektit |
| KP | Kërkesat e Performancës (të BERZH-it) |
| KRUB | Kompania Rajonale e Ujësullës Bifurkacioni |
| PAPI | Plani për Angazhim të Palëve të Interesit |
| ITUZ | Impiant për Trajtim të Ujërave të Zeza |

| | |
|---|-----------|
| LISTA E PËRKUFIZIMEVE PËR TERMAT E PËRDORUR NË KËTË DOKUMENT | 4 |
| 1 HYRJE | 6 |
| 1.1 Përshkrim i Shkurtër i Projektit..... | 6 |
| 1.2 Rreth kësaj Kornize për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës..... | 8 |
| 1.3 Vlerësimi paraprak i ndikimeve të lidhura me blerjen e tokës | 9 |
| 1.4 Statusi i veprimtarive për blerje të tokës | 11 |
| 2 SHQYRTIMI LIGJOR DHE ANALIZA E HENDEKËVE | 12 |
| 2.1 Korniza Rregullatore e Kosovës..... | 12 |
| 2.2 Kërkesat e BERZH-it..... | 12 |
| 2.3 Analiza e mangësive dhe zgjidhjeve | 13 |
| 3 PARIMET KYÇE PËR BLERJE TË TOKËS | 17 |
| 4 PRANUESHMËRIA DHE TË DREJTAT | 20 |
| 5 SHPALOSJA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMET | 22 |
| 6 ARANZHIMET E ZBATIMIT | 23 |
| 7 MEKANIZMI PËR ANKESA | 24 |

LISTA E PËRKUFIZIMEVE PËR TERMAT E PËRDORUR NË KËTË DOKUMENT

| | |
|---|--|
| REGJISTRIMI DHE ANKETA SOCIO-EKONOMIKE | Regjistrimi është procesi për mbledhjen e 100% të popullatës së individëve, amvisërive dhe bizneseve (formale ose informale) të cilat do të zhvendosen fizikisht dhe/ose ekonomikisht nga një projekt. Anketa socio-ekonomike përdoret për të përcaktuar dhe analizuar kushtet socio-ekonomike të individëve, amvisërive dhe bizneseve (formale ose informale) të cilat do të zhvendosen fizikisht dhe ekonomikisht nga një projekt (<i>shih përkufizimet e zhvendosjes fizike dhe ekonomike më poshtë</i>). |
| DATA E NDËRPRERJES | Data pas së cilës kushdo që vendoset në zonën e projektit nuk ka më të drejtë për kompensim dhe/ose ndihmë. |
| PMS e vitit 2019 e BERZH-it: KP5 | Kërkesa e Performancës (KP) 5 i trajton ndikimet e blerjes së tokës në lidhje me projektin, duke përfshirë kufizimet në përdorimin e tokës dhe qasjen në asete dhe burime natyrore, të cilat mund të shkaktojnë zhvendosje fizike (relokim, humbje të tokës ose strehimit) dhe/ose zhvendosje ekonomike (humbje të tokës, aseteve ose kufizime në përdorimin e tokës, aseteve dhe burimeve natyrore që shpjen në humbje të burimeve të të hyrave ose mjeteve të tjera të jetesës). |
| ZHVENDOSJA EKONOMIKE | Humbja e aseteve (përfshirë tokën) ose qasjes në asete që shpie në humbje të të hyrave ose mjeteve të jetesës si rezultat i projektit. Personat ose ndërmarrjet mund të zhvendosen ekonomikisht me ose pa përjetuar zhvendosje fizike. |
| E DREJTA | Kompensimi dhe ndihma që personat e prekur kanë të drejtë të marrin gjatë risistemimit (<i>shih përkufizimin e risistemimit më poshtë</i>). Të drejtat përcaktohen për çdo projekt individual dhe renditen në formën e një matrice të të drejtave, d.m.th. një tabelë e paraqitur në KBTRMJ/PBTRMJ dhe që përmban informata se kush ka të drejtë për çfarë lloj kompensimi dhe/ose ndihme. |
| RIMËKËMBJA E MJETEVE TË JETESËS | Masat e zbatuara për të zbutur efektet e zhvendosjes ekonomike - domethënë, për të përmirësuar ose, së paku, për të rimëkëmbur mjetet e jetesës dhe standardet e jetesës së personave të prekur në nivelet para zhvendosjes. |
| VLERA E TREGUT | Vlera e llogaritur në bazë të çmimeve të pronës në zonën në të cilën është fituar prona e caktuar, e cila mund të arrihet për një pronë të caktuar në treg, në varësi të ofertës dhe kërkesës në atë moment të përcaktimit të çmimit. |
| PAGESA E LËVIZJES | Kompensimi në para të gatshme për kostot që lidhen drejtpërdrejt me lëvizjen/relokimin e një amvisërie ose biznesi. |
| ZHVENDOSJA FIZIKE | Humbja e shtëpisë, banesës ose strehimit si rezultat i blerjes së tokës në lidhje me projektin që kërkon që personi i prekur të zhvendoset në një vend tjetër. |
| PERSONA TË PREKUR NGA PROJEKTI (PPP) | Secili person i cili, si rezultat i blerjes së tokës që kërkohet nga projekti, humbet të drejtën për të poseduar, përdorur ose përfituar ndryshe nga një strukturë e ndërtuar, tokë, kultura dhe pemë vjetore ose shumëvjeçare, ose çdo aset tjetër i paluajtshëm ose i luajtshëm, plotësisht ose pjesërisht, përgjithmonë ose përkohësisht. |
| KOSTO E ZËVENDËSIMIT | "Kosto e zëvendësimit" përkufizohet si një metodë vlerësimi që jep kompensim të mjaftueshëm për të zëvendësuar asetet, plus kostot e nevojshme të transaksionit që lidhen me zëvendësimin e aseteve. Aty ku ekzistojnë tregje funksionale, kosto e zëvendësimit është vlera e tregut siç përcaktohet përmes vlerësimit të pavarur dhe kompetent të pasurive të paluajtshme, plus kostot e transaksionit. Aty ku tregje të tilla nuk ekzistojnë, kosto e zëvendësimit mund të përcaktohet nëpërmjet mjeteve alternative, të tilla si llogaritja e vlerës së pazhlerësuar të materialit zëvendësues dhe punës për ndërtimin e strukturave ose aseteve të tjera të paluajtshme, plus kostot e transaksionit. Në të gjitha rastet kur zhvendosja fizike rezulton në humbjen e strehimit, kosto e zëvendësimit duhet të paktën të jetë e mjaftueshme për të mundësuar blerjen ose ndërtimin e banimit që i plotëson standardet minimale të pranueshme të cilësisë dhe sigurisë. |

| | |
|---|--|
| <p>KORNIZA PËR BLERJE TË TOKËS/RIMËKËMBJE TË MJETEVE TË JETESËS (KBTRMJ)</p> | <p>Një dokument i zhvilluar kur për shkak të fazës së zhvillimit të projektit nuk dihet natyra ose madhësia e saktë e blerjes së tokës ose kufizimet në përdorimin e tokës në lidhje me një projekt me potencial për të shkaktuar zhvendosje fizike dhe/ose ekonomike. Qëllimi i një kornize është të përshkruajë ndikimet e mundshme që lidhen me blerjen e tokës dhe të përshkruajë parimet që do të ndiqen për t'i trajtuar ato. Pasi të përcaktohen komponentët individualë të projektit dhe informacioni i kërkuar bëhet i disponueshëm, korniza shërben si bazë për zhvillimin e një plani të detajuar (<i>shih pikën Planit për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës më poshtë</i>).</p> |
| <p>PLANI PËR BLERJE TË TOKËS DHE RIMËKËMBJE TË MJETEVE TË JETESËS (PBTRMJ)</p> | <p>Dokumenti në të cilin një klient specifikon procedurat që do të ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë për të zbutur efektet negative, për të kompensuar humbjet dhe për të ofruar përfitime zhvillimore për personat dhe komunitetet e prekura nga një projekt investimi. Qëllimi i planit është t'u paraqesë të gjitha palëve të interesuara, përfshirë personat e prekur, se cilët saktësisht do të preken nga blerja e tokës, si do të zbatohet blerja dhe nga kush, si dhe afatin kohor dhe burimet.</p> |
| <p>RISISTEMIMI</p> | <p>Zhvendosja fizike (relokimi ose humbja e strehimit) dhe zhvendosja ekonomike (humbja e aseteve ose burimeve dhe/ose humbja e qasjes në asete ose burime që shpie në humbjen e burimeve të të hyrave ose mjeteve të jetesës) si rezultat i blerjes së tokës në lidhje me projektin dhe/ose kufizime në përdorimin e tokës.</p> |
| <p>PALËT E INTERESIT</p> | <p>Secili dhe të gjithë individët, grupet, organizatat dhe institucionet e interesuara dhe potencialisht të prekura nga një projekt ose që kanë aftësinë për të ndikuar në një projekt.</p> |
| <p>GRUPET E CENUESHME</p> | <p>Persona ose grupe të personave që mund të preken më keq nga ndikimet e projektit sesa të tjerët për shkak të karakteristikave të tilla si gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, feja, përkatësia etnike, statusi indigjen, mosha (duke përfshirë fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit), paaftësia fizike ose mendore, njohuritë për shkrim-lexim, pikëpamjet politike ose statusi social. Individët dhe/ose grupet e cenueshme mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, persona në situata të cenueshme, siç janë personat që jetojnë nën kufirin e varfërisë, personat pa tokë, amvisëritë me prind vetë-ushqyes, komunitetet e varura nga burimet natyrore, punëtorët migrantë, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit, ose persona të tjerë të zhvendosur që mund të mos mbrohen nëpërmjet legjisllacionit kombëtar dhe/ose ligjit ndërkombëtar publik.</p> |

1 HYRJE

1.1 Përshkrim i Shkurtër i Projektit

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton ofrimin e financimit për Qeverinë e Kosovës për të financuar modernizimin dhe rindërtimin e infrastrukturës për trajtim të ujërave të zeza dhe të kanalizimeve në Ferizaj. Infrastruktura e ujit dhe ujërave të zeza në Ferizaj operohet dhe menaxhohet nga subjekti publik Kompania Rajonale e Ujësjes Bifurkacioni (KRUB), e cila i ofron shërbimet e veta brenda kufijve administrativë të tri komunave: Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit.

Megjithatë, nuk ka një impiant për trajtimin e ujërave të zeza (ITUZ), dhe një pjesë e konsiderueshme e seksioneve të vjetra të rrjetit të ujërave të zeza është në gjendje të pariparuar, duke përjetuar shpesh bllokime të gypave për shkak të akumulimit të sedimentit. Mangësitë në rrjetet ekzistuese të ujërave të zeza dhe mungesa e shërbimeve të trajtimit të ujërave të zeza kanë rezultuar në ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Prandaj, ekziston nevoja urgjente për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të zeza, çka do të përmirësonte cilësinë e shërbimeve të ujërave të zeza, si dhe cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Projekti kategorizohet "B" ¹në përputhje me Politikën Mjedisore dhe Sociale të vitit 2019 (PMS)².

Projekti do të menaxhohet nga një Njësi e Zbatimit të Projektit (NJZP) që përbëhet nga përfaqësues të KRUB-së dhe qeverisë qendrore (ministritë relevante).

Në vitin 2014, si kontribut në procesin e para-anëtarësimit të Kosovës, BE-ja financoi një Studim Fizibiliteti për të vlerësuar kërkesat për trajtimin e ujërave të zeza për Ferizajn. Në vitin 2023, BERZH-i lansoi një "rifreskim" të Studimit të Fizibilitetit nga konsulentë të pavarur, së bashku me një vlerësim Mjedisor dhe Social (MS) të projektit.

Bazuar në Studimin e Fizibilitetit të përditësuar, Projekti do të mbulojë:

1. **ndërtimin e një ITUZ** (kapaciteti prej 90,000 ekuivalent i popullsisë) për t'u shërbyer qendrës urbane të Ferizajt dhe fshatrave të lidhura me të, si dhe tri fshatrave në komunën fqinje të Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj, Bajnicë), si dhe **ndërtimin e një rruge hyrëse për në ITUZ** (rruga duhet ende të përcaktohet),
2. **zgjerimin e kolektorit kryesor ekzistues** nga lokacioni aktual afër fshatit Gërlicë deri në lokacionin e propozuar të ITUZ-it (rreth 3 km), dhe
3. **ndërtimin e një pjese të vogël të rrjetit të ri të ujërave të zeza** që kërkohet për të lidhur kolektorin kryesor me fshatrat Varosh, Grackë, Rakaj, Gërlicë dhe Doganaj (gjithsej më pak se 2 km), si dhe tri fshatra të komunës së Kaçanikut (Koxhaj, Elezaj, Bajnicë) (gjatësia nuk dihet për momentin).

Përfitimet e projektit përfshijnë:

- Projekti do të grumbullonte dhe trajtonte ujërat e zeza nga përafërsisht 75% e popullsisë në Komunën e Ferizajt.
- Të gjitha shkarkimet e ujërave të zeza në zonën e mbledhëse do të kapeshin dhe largoheshin nga lumi Nerodime, menjëherë në rrjedhën e sipërme të Komunës së Kaçanikut ngjitur.
- Kjo do të ketë një përmirësim të konsiderueshëm në cilësinë e ujit të lumit Nerodime, i cili është ndërkufitar me Maqedoninë e Veriut si dhe me Greqinë, duke kontribuar kështu në Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat. ITUZ-i do të trajtonte përafërsisht 5000 kg/ditë mbetje organike.

¹Një projekt kategorizohet "B" kur ndikimet e tij të mundshme mjedisore dhe/ose sociale janë zakonisht specifike për lokacionin dhe/ose identifikohen dhe adresohen lehtësisht përmes masave efektive zbutëse.

² PMS e BERZH-it është e disponueshme në: <https://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

- Sistemi kolektor përfshin kapacitet për zgjerim në të ardhmen dhe përfshin rrjedhat nga tri fshatra të komunës së Kaçanikut.
- Projekti është në përputhje me planet zhvillimore për ujëra të zeza të komunës.

Lokacioni i propozuar për ITUZ-in është planifikuar të vendoset në tokë të rrafshët bujqësore, që gjendet në Komunën e Kaçanikut, në jug të fshatit Gërlicë. Sipërfaqja prej 8.1 hektarësh është aktualisht e klasifikuar si tokë bujqësore dhe në pronësi private. Figura e parë më poshtë tregon një pamje në Google Earth të lokacionit të planifikuar të ITUZ-it dhe figura e dytë tregon një foto të lokacionit.



Figura 1-1: Pamje në Google Earth e lokacionit të planifikuar të ITUZ-it



Figura 1-2: Foto e lokacionit të planifikuar të ITUZ-it

1.2 Rreth kësaj Kornize për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës

Kjo Korniza për Blerje të Tokës dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës (KBTRMJ) (KBTRMJ) është zhvilluar si pjesë e Vlerësimit MS për projektin e planifikuar. Është përgatitur që të jetë në pajtueshmëri me legjislacionin e Kosovës dhe Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (2019), më konkretisht Kërkesën e Performancës (KP) 5: Blerje e tokës, kufizime në përdorimin e tokës dhe risistemim i pavullnetshëm. Këto kërkesa përshkruhen më në detaje në kapitullin 2 të kësaj KBTRMJ-e.

Gjatë zhvillimit të Projektit, analiza paraprake e ndikimeve të Projektit tregoi se Projekti do të shpjerë në blerje të tokës, siç është elaboruar në seksionin 1.3 të këtij Kapitulli. Megjithatë, natyra ose madhësia e ndikimeve të lidhura me blerjen e tokës është aktualisht e panjohur për shkak të fazës së zhvillimit të projektit dhe nuk mund të kryhet një regjistrim i detajuar i personave dhe aseteve të prekura. Prandaj, kjo KBTRMJ është zhvilluar në një fazë shumë të hershme të Projektit për të përcaktuar objektivat, parimet dhe qasjen për të kompensuar blerjen e tokës dhe zhvendosjen ekonomike që rrjedhin nga zbatimi i projektit dhe për të siguruar që rimëkëmbja e mjeteve të jetesës të kryhet në përputhje me KP5 të BERZH-it. Nuk pritet asnjë risistemim fizik, dhe nuk mbulohet në këtë Kornizë.

Objektivat e KBTRMJ-së janë:

- a) Të përcaktohet një kornizë për të minimizuar zhvendosjen ekonomike dhe, aty ku zhvendosja është e pashmangshme, të përmirësohen, ose minimalisht të rimëkëmben në nivelet para projektit mjetet e jetesës dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur pas zbatimit të projektit.
- b) Të sigurohet që personat e prekur pa titull pronësia mbi tokën ose ndonjë të drejtë ligjore të njohur mbi tokën, të kenë të drejtë për kompensim për humbjen e aseteve jotokësore dhe rimëkëmbjen e mjeteve të jetesës. Në përputhje me kërkesat e BERZH-it, në këta persona mund të përfshihen pronarë ose jo pronarë dhe persona që tokën e përdorin pa të drejta përdorimi formale ose të njohura.
- c) Të përcaktohen kërkesat për shpalosje të informacionit, konsultimin dhe pjesëmarrje të informuar të personave të prekur. Dispozita të veçanta që duhen bërë për individët që u përkasin grupeve të cenueshme, për t'u siguruar që këta persona të përfshihen në proces.
- d) Të përcaktohet si kryhet monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të rimëkëmbjes së mjeteve të jetesës, ndikimet e tyre në standardet e jetesës së personave të zhvendosur dhe nëse janë arritur objektivat e planit për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës.
- e) Të përshkruhet mekanizmi ose procedura specifike për zgjidhje të ankesave që duhet të ndiqet për të arritur dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve të personit të prekur.
- f) Të sigurohet që ndikimet në grupet e cenueshme janë identifikuar, vlerësuar dhe adresuar, dhe se janë planifikuar konsultime specifike me grupet e cenueshme dhe janë përcaktuar masat e duhura të ndihmës.

Kjo KBTRMJ është baza për zhvillimin e një Plani të detajuar plan për Blerje të Tokave dhe Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës (PBTRMJ) i cili do të zhvillohet sapo të bëhet e njohur natyra e saktë dhe qëllimi i blerjes së tokës (d.m.th. pas zhvillimit të Studimit të Shpronësimit bazuar në dokumentacionin e dizajnit të ardhshëm). PBTRMJ do të zhvillohet në bazë të informacionit të besueshëm dhe të përditësuar dhe do të përfshijë informata bazë për projektin, ndikimet, personat dhe pronat e prekura, si dhe të drejtat e të gjitha kategorive të personave të prekur. PBTRMJ do të përfshijë gjithashtu buxhete të detajuara dhe afate kohore.

1.3 Vlerësimi paraprak i ndikimeve të lidhura me blerjen e tokës

Kjo pjesë përshkruan ndikimet e mundshme që lidhen me blerjen e tokës që kërkohet për ndërtimin e ITUZ-it dhe komponentëve të lidhur infrastrukturorë.

1. **Ndërtimi i ITUZ-it:** Aspekti kryesor i Projektit përfshin blerjen e përhershme të 33 parcelave të tokës në pronësi private të destinuar për ndërtimin e ITUZ-it. ITUZ-i ka për synim të zërë 8.1 ha tokë të rrafshët që ndodhet në Komunën e Kaçanikut, në jug të fshatit Gerlicë. Këto parcela aktualisht janë të kategorizuara si tokë bujqësore.

Komuna e Kaçanikut ka ofruar të dhëna të përkohshme për fushëveprimin e vlerësuar të blerjes së tokës, llojin e tokës që do të blihet, si dhe numrin e pronarëve të tokës, bazuar në informacionin kadastral. Megjithatë, informatat e sakta për fushëveprimin e saktë të blerjes së tokës do të jenë në dispozicion vetëm pas zhvillimit të studimit të shpronësimit siç kërkohet me Ligjin e Kosovës për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme. Nuk pritet asnjë zhvendosje fizike pasi që nuk ka struktura në tokën që do të blihet.

Figura më poshtë tregon parcelat e tokës siç janë përcaktuar në Planin Kadastral të dorëzuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Kaçanikut.




Figura 1-3: Ekstrakt nga Plani Kadastral

Tabela e mëposhtme tregon përmbledhjen e të dhënave të futura aktualisht në Planin Kadastral të përmendur (pa informacion konfidencial).

| Nr. | Nr. kadastral | Sipërfaqe (m ²) | Numri i pronarëve | Lloji i tokës | Klasifikimi |
|----------------------------|--------------------|-----------------------------|-------------------|---------------|----------------------|
| 1. | P-70917086-00068-2 | 2641 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 2. | P-70917086-00068-3 | 3094 | 5 | Bujqësore | Livadh |
| 3. | P-70917086-00068-4 | 1351 | 5 | Bujqësore | Kullota |
| 4. | P-70917086-00068-5 | 1281 | 1 | Bujqësore | Kullota |
| 5. | P-70917086-00069-0 | 5644 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 6. | P-70917086-00070-0 | 685 | 1 | Bujqësore | Tokë buke |
| 7. | P-70917086-00071-0 | 850 | 1 | Bujqësore | Tokë buke |
| 8. | P-70917086-00072-0 | 2208 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 9. | P-70917086-00073-0 | 2188 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 10. | P-70917086-00074-0 | 745 | 1 | Bujqësore | Tokë buke |
| 11. | P-70917086-02207-0 | 2250 | 1 | Bujqësore | Livadh dhe tokë buke |
| 12. | P-70917086-00077-0 | 3662 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 13. | P-70917086-00078-0 | 790 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 14. | P-70917086-00079-1 | 5946 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 15. | P-70917086-00079-2 | 5153 | 5 | Bujqësore | Livadh |
| 16. | P-70917086-00079-3 | 5676 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 17. | P-70917086-00079-4 | 4520 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 18. | P-70917086-00080-0 | 2609 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 19. | P-70917086-02246-1 | 1272 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 20. | P-70917086-02246-2 | 1273 | 2 | Bujqësore | Livadh |
| 21. | P-70917086-02246-3 | 1271 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 22. | P-70917086-02246-4 | 1271 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 23. | P-70917086-02246-5 | 5088 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 24. | P-70917086-02246-6 | 4587 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 25. | P-70917086-02298-1 | 2522 | Nuk ka | Bujqësore | Nuk ka |
| 26. | P-70917086-02298-2 | 1264 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 27. | P-70917086-02298-3 | 1263 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 28. | P-70917086-00212-0 | 1833 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 29. | P-70917086-00213-0 | 807 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 30. | P-70917086-00214-0 | 598 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 31. | P-70917086-00215-0 | 2071 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 32. | P-70917086-00216-0 | 3127 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| 33. | P-70917086-00217-0 | 1534 | 1 | Bujqësore | Livadh |
| Gjithsej sipërfaqja | | 81074 m² | | | |

Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Kaçanikut, Konsulenti ka vërejtur se nga numri i përgjithshëm i pronarëve të tokave, 7 i përkasin grupit etnik serb, ndërsa pronarët e mbetur janë pjesëtarë të shumicës kombëtare (shqiptare).

Gjatë vizitave në terren në korrik dhe gusht 2023, u vu re se toka nuk është vënë në përdorim, as për kultivim, as për ndonjë aktivitet bujqësor, as aktualisht dhe as në të kaluarën e afërt. Toka të jep përshtypjen se është e lënë pas dore dhe e papërdorur për një periudhë të gjatë, përkundër klasifikimit të saj zyrtar si tokë bujqësore. Nuk është identifikuar asnjë përdorues sezonal apo përdorues informal.

- Zgjerimi i kolektorit kryesor ekzistues nga lokacioni aktual afër fshatit Gërlicë deri në lokacionin e propozuar të ITUZ-it (rreth 3 km):** Nuk parashikohet që blerja e tokës të jetë e nevojshme për zgjerimin e kolektorit kryesor për shkak të vendosjes së tij të planifikuar përgjatë linjës ekzistuese hekurudhore.
- Ndërtimi i një pjese të vogël të rrjetit të ri të ujërave të zeza** që kërkohet për të lidhur kolektorin kryesor me fshatrat Varosh, Grackë, Rakaj, Gerlicë dhe Doganaj, Koxhaj, Elezaj dhe Bajnicë: Gjurma e saktë do të përcaktohet në fazat e ardhshme të dizajnit, por pritet që tubacionet e reja të vendosen përgjatë rrugëve lokale, kështu që nuk do të jetë e nevojshme blerja e tokës private.
- Rrugë për qasje:** Aktualisht, mbetet e paqartë nëse do të nevojitet blerja e tokës për ndërtimin e rrugës për qasje në lokacionin e ITUZ-it. Kjo do të përcaktohet në fazat e ardhshme të dizajnit.

5. **Furnizimi me energji elektrike:** Meqenëse nuk ka furnizim me energji elektrike në lokacionin e ITUZ-it, linja ekzistuese me tension të lartë e cila shtrihet deri në stacionin e trenit në Gerlicë do të duhet të zgjatet deri në lokacionin e ITUZ-it (rreth 500 m) në bashkëpunim me KESCO (Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike). Nuk dihet ende nëse do të preket ndonjë tokë private nga zgjerimi i furnizimit me energji elektrike.
6. Mund të nevojitet **zënie e përkohshme e tokës gjatë ndërtimit** (për kampet e ndërtimit, zonat e shtrimit të materialeve, ruajtjen e dherave të sipërme dhe materialeve të gërmuara, etj.) siç do të vendoset nga kontraktori i ardhshëm.

1.4 Statusi i veprimtarive për blerje të tokës

Siç u përmend më lart, ITUZ-i synon të zërë përafërsisht 8.1 hektarë tokë të rrafshët në Komunën e Kaçanikut. Kjo Komunë ka marrë një Vendim me interes publik më 30 qershor 2016, duke shënuar fazën fillestare të procesit të shpronësimit. Vendimi është publikuar vetëm përmes ueb faqes së Komunës së Kaçanikut.

Duhet të theksohet se qeveria qendrore (d.m.th. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Departamenti për Shpronësim) do të veprojë si autoritet shpronësues për këtë projekt.

Kjo parcelë është përfshirë edhe në Draft Planin Zhvillimor Komunal të Kaçanikut, i cili pritet të marrë miratimin përfundimtar deri në fund të vitit. Procesi është drejt përfundimit. Akti i përfshirjes në Planet Hapësinore Komonale e riklasifikon menjëherë tokën nga tokë bujqësore në tokë urbane (ndërtimore).

Deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet tjetër në lidhje me blerjen e tokës. Konsultimet me pronarët e tokave të prekura nuk janë kryer ende.

2 SHQYRTIMI LIGJOR DHE ANALIZA E HENDEKËVE

Projekti do të plotësojë kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe politikave të BERZH-it, veçanërisht Kërkesën e Performancës 5 të BERZH-it për blerjen e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe risistemimin e pavullnetshëm. Aty ku ekzistojnë mospërputhje ndërmjet ligjit kombëtar dhe kërkesave të BERZH-it, NJZP-ja merr përsipër të ndjekë kërkesat e BERZH-it kur këto janë më të dobishme për personat e prekur nga Projekti.

2.1 Korniza Rregullatore e Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta ndalon privimin arbitrar të pronës. Autoritetet mund ta shpronësojnë pronën vetëm nëse një shpronësim i tillë autorizohet me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e një qëllimi publik ose promovimin e interesit publik dhe pasohet nga sigurimi i kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin(at) prona e të cilit është shpronësuar.

Ligji për Shpronësimin e Pasurisë së Paluajtshme

Procedura e shpronësimit të tokës dhe risistemimit në Kosovë rregullohet kryesisht me Ligjin për Shpronësimin e Pasurisë së Paluajtshme Nr. 03/L-139, i datës 23 prill 2009 (i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-205 i datës 17 nëntor 2010). Ligji përshkruan procedurën, duke përfshirë mjetet juridike për të mbrojtur individët nga ndërhyrjet joproporcionale në të drejtën e pronës së paluajtshme.

Kompensimi është i rregulluar si me Ligjin e përmendur *ashtu edhe me Udhëzimin Administrativ për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet, dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin*, Nr. 02/2015.

Vetëm personat me të drejta dhe kërkesa të njohura kanë të drejtë në kompensim. Kompensimi paguhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, duke përfshirë pjesët shtesë dhe frytet e saj, plus çdo dëm të drejtpërdrejtë të dukshëm të shkaktuar për shkak të shpronësimit. Kompensimi paguhet me para të gatshme (me transfer bankar), ndërsa kompensimi në natyrë jepet ekskluzivisht në rastet kur autoriteti shpronësues është qeveria qendrore dhe arritja e objektivit publik përkatës kërkon shpronësimin e mbi 20 parcelave. Në raste të tilla, kompensimi i ofruar mund të jetë ose sigurim i tokës zëvendësuese me një vlerë të barabartë me kompensimin e detyruar ose një kombinim i parave të gatshme dhe tokës zëvendësuese (vlera kolektive e së cilës është e barabartë me kompensimin e detyruar).

Nuk zbatohet asnjë ndryshim në pronësi apo të drejta të tjera të personave të prekur derisa të hyjë në fuqi Vendimi Përfundimtar për Shpronësimin dhe të jetë paguar kompensimi i kërkuar nga Vendimi Përfundimtar.

2.2 Kërkesat e BERZH-it

Kërkesat relevante të cilat duhet të përmbushen nga Projekti janë të përshkruara në Kërkesën e Performancës 5 të BERZH-it: Blerje e tokës, kufizime në përdorimin e tokës dhe risistemim i pavullnetshëm. KP5 e BERZH-it thekson se “risistemimi i pavullnetshëm i referohet si zhvendosjes fizike ashtu edhe zhvendosjes ekonomike që rezultojnë nga blerja e tokës në lidhje me projektin ose qasja e kufizuar në mjetet e jetesës dhe burimet natyrore”.

Risistemimi konsiderohet i pavullnetshëm kur individët ose komunitetet e prekura nuk kanë të drejtë ta refuzojnë blerjen e tokës që rezultojnë në zhvendosje. Risistemimi i pavullnetshëm i menaxhuar keq mund të çojë në vështirësi afatgjata, dëmtime mjedisore dhe efekte të pafavorshme socio-ekonomike në zonat e reja të vendbanimeve. Ai gjithashtu mund ta ekspozojë klientin ndaj veprimeve ligjore, veçanërisht në juridiksione me kufizime në mjete juridike ose mbrojtje për individët e zhvendosur. Prandaj, këshillohet të shmangët ose minimizohet risistemimi i pavullnetshëm. Megjithatë, kur nuk mund të shmangët, masat e duhura duhet të planifikohen dhe zbatohen me përpikëri. Marrëveshjet e negociuara rekomandohen fuqimisht pasi që ato ndihmojnë në parandalimin e shpronësimit dhe

nevojën për largim të detyruar nga qeveria. Këto marrëveshje mund të arrihen duke ofruar kompensim të drejtë, stimuj dhe përfitime për palët e prekura, ndërkohë që zbuten pabarazitë e informacionit dhe fuqisë negociuese. Klientët inkurajohen të fitojnë të drejtat e tokës përmes marrëveshjeve të negociuara, edhe nëse ata kanë mjete ligjore për qasje në tokë pa pëlqimin e shitësit.

'Personat e zhvendosur mund të klasifikohen si persona i) që kanë të drejta ligjore formale në tokë, ii) që nuk kanë të drejta ligjore formale në tokë në kohën e regjistrimit, por që kanë pretendime për tokën që njihen ose mund të njihen sipas ligjit kombëtar; ose iii) të cilët nuk kanë asnjë të drejtë ligjore ose pretendim të njohur për tokën që kanë zënë'.

Objektivat e KP 5 përfshijnë:

- të shmanget ose të paktën të minimizohet risistemimi i pavullnetshëm, kudo që është e mundur, duke eksploruar dizajne alternative të projektit
- të zbuten ndikimet e pafavorshme sociale dhe ekonomike nga blerja e tokës ose kufizimet në përdorimin dhe qasjen në tokë nga personat e prekur, përmes: (i) sigurimit të kompensimit për humbjen e aseteve me koston e zëvendësimit; dhe (ii) sigurimit që aktivitetet e risistemimit të zbatohen me shpalosjen e duhur të informacionit, konsultimin dhe pjesëmarrjen e informuar të atyre që preken
- të përmirësohen ose, minimalisht, të rimëkëmben mjetet e jetesës dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur në nivelet para projektit, nëpërmjet masave që mund të bazohen në ndërmarrje, të bazuara në paga dhe/ose të bazuara në ndërmarrje, në mënyrë që të lehtësojnë përmirësime të qëndrueshme në statusin e tyre socio-ekonomik
- të përmirësohen kushtet e jetesës në mesin e personave të zhvendosur përmes ofrimit të banimit adekuat me siguri të qëndrimit në lokacionet e risistemimit.

2.3 Analiza e mangësive dhe zgjidhjeve

Më poshtë jepet një krahasim i legjislacionit kombëtar dhe kërkesave të BERZH-it. KBTRMJ është dizajnuar për të përmbushur legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BERZH-it, megjithatë, aty ku ekzistojnë hendekë, procesi i KBTRMJ-së do të ndjekë standardet më të dobishme për personat dhe subjektet e prekura.

Ligjet dhe rregulloret e Kosovës ndryshojnë nga KP5 e BERZH-it në fushat e mëposhtme:

Tabela 2-1: Përmbledhje e hendekeve ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe kërkesave të BERZH-it

| Çështja | Kërkesa e BERZH-it | Dispozita e Ligjit të Kosovës | Masat për mbyllje të hendekut |
|------------------------------|--|--|---|
| Procesi i planifikimit | Kërkon që Klienti të kryejë një vlerësim bazë socio-ekonomik të personave të prekur nga Projekti, në mënyrë që të identifikojë ndikimet që lidhen me blerjen e tokës dhe kufizimet në përdorimin e tokës, si dhe të zhvillojë veprimet e duhura për të minimizuar dhe zbutur ndikimet e risistemimit. Kërkon përgatitjen dhe zbatimin e planeve të detajuara për blerje të tokës. | Kërkon vetëm një studim shpronësimi si regjistrim bazë; asnjë kërkesë e qartë në lidhje me anketat socio-ekonomike ose zhvillimin e planeve për blerje të tokës dhe risistemim. | PBTRMJ i detajuar do të zhvillohet për Projektin pasi të dihet natyra dhe madhësia e saktë e blerjes së tokës, d.m.th. pas zhvillimit të Studimit të Shpronësimit të kërkuar nga legjislacioni kombëtar, dhe do të kryhet një regjistrim i detajuar dhe një anketë socio-ekonomike, duke identifikuar si përdoruesit formalë ashtu edhe joformalë të tokës/pronës, si dhe personat/familjet e cënueshme dhe mjetet e jetesës së të gjithë personave të prekur nga Projekti. |
| Data e ndërprerjes | Kërkon që klienti të vendosë një datë të ndërprerjes për pranueshmërinë dhe që data e ndërprerjes të komunikohet në të gjithë zonën e projektit. | Parashikon që kompensimi nuk do të paguhet për koston ose vlerën për ndonjë përmirësim të pronës pas datës në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës për përpunim të mëtejshëm të shpronësimit është botuar në Gazetën Zyrtare, ose për çdo ndryshim në vlerën e tregut të pronës, ose pas datës së miratimit të vendimit për autorizimin e veprimtarive përgatitore ose datës së paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim, cilado qoftë e para. | Datat e ndërprerjes të përcaktuara në legjislacionin vendas (dhe të specifikuar në PBTRMJ) do të përdoren në kombinim me datën e regjistrimit dhe inventarit të aseteve si datë e ndërprerjes për personat pa ndonjë të drejtë të njohur – nëse ka. Personat e prekur duhet të informohen për datën e ndërprerjes. |
| Marrëveshjet e negociuara | Klientët pritet të kërkojnë ta blejnë pronën përmes marrëveshjeve të negociuara duke ofruar kompensim të drejtë dhe të përshtatshëm edhe nëse i kanë mjetet ligjore për të fituar qasje në tokë përmes procedurës së shpronësimit. | Nuk kërkon apo inkurajon marrëveshje të negociuara. | Marrëveshjet e negociuara do të kryhen aty ku është e mundur, përpara se të fillojë procesi i shpronësimit. |
| Vlera e kompensimit dhe koha | Kompensimi për asetet e humbura do të sigurohet me koston e zëvendësimit dhe do të sigurohet përpara se personi/personat e prekur të përjetojnë një humbje. | Kompensimi paguhet në bazë të vlerës së tregut të pronës. Qasja në tokë dhe pronë nga autoriteti shpronësues nuk lejohet deri sa pronarët e prekur ta marrin kompensimin. | Kompensimi do të sigurohet në përputhje me kërkesat e BERZH-it dhe do të paguhet përpara hyrjes në tokë, siç përcaktohet në kapitullin "Parimet kyçe". Të drejtat specifike janë të listuara në Matricën e të Drejtave. |
| Pranueshmëria për kompensim | Personat e prekur nga projekti në kuptim të KP 5 të BERZH-it mund të klasifikohen si: a) Ata që kanë të drejta ligjore formale në tokë (përfshirë të drejtat zakonore dhe tradicionale të njohura sipas ligjeve | Vetëm personat me të drejta dhe kërkesa të njohura kanë të drejtë në kompensim. | E drejta për kompensim dhe rimëkëmbje të mjeteve të jetesës do të shtrihet tek personat e prekur të cilët nuk kanë të drejta ligjore të njohura ose pretendojnë tokën që e përdorin për mjetet e tyre të jetesës, të cilët do të |

| Çështja | Kërkesa e BERZH-it | Dispozita e Ligjit të Kosovës | Masat për mbyllje të hendekut |
|----------------------|--|---|---|
| | <p>kombëtare) – kanë të drejtë për kompensim për humbjen e asetëve me kosto zëvendësimi</p> <p>b) Ata që nuk kanë të drejta ligjore formale në tokën në kohën e regjistrimit, por që kanë një pretendim për tokën që njihet ose mund të njihet sipas ligjeve kombëtare – kanë të drejtë për kompensim për humbjen e asetëve me kosto zëvendësimi</p> <p>c) Ata që nuk kanë asnjë të drejtë ligjore ose pretendim të njohur për tokën që zënë – kanë të drejtë për banim adekuat me siguri të qëndrimit nëse zhvendosen fizikisht dhe/ose kompensim për çdo humbje në tokë (kultura, infrastrukturë në tokë, etj.) nëse zhvendosen ekonomikisht</p> | | <p>identifikohen përmes regjistrimit gjatë përgatitjes së PBTRMJ-së.</p> |
| Grupet e cenueshme | <p>KP 5 e BERZH-it kërkon që grupet e cenueshme të identifikohen në kohën e anketave socio-ekonomike, të konsultohen dhe të sigurohen masa ndihme të përshtatura për nevojat e tyre.</p> | <p>Asnjë dispozitë specifike në ligj. Megjithatë, ndihma dhe mbrojtja e grupeve 'në risk' ofrohet, deri në një farë mase, në bazë të ligjeve të veçanta që rregullojnë të drejtat e njeriut duke përfshirë të drejtat pronësore (Ligji për financimin e programeve specifike të banimit, i cili ofron mundësi banimi për grupet e cenueshme; Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i cili përcakton masat për mbrojtjen e personave që u përkasin komuniteteve të caktuara të njohura në Kosovë).</p> | <p>Grupet e cenueshme duhet të identifikohen përmes regjistrimit dhe anketës. Në rast se identifikohen grupe të cenueshme dhe pakica etnike, PBTRMJ duhet të përcaktojë qartë modalitetin dhe nivelin e kërkuar të konsultimeve dhe ndihmës për grupe të tilla.</p> <p>Nëse është e nevojshme, duhet të konsultohen autoritetet përgjegjëse për sigurimin e mirëqenies sociale dhe të përfshihen në zbatimin e PBTRMJ-së.</p> <p>I gjithë komunikimi dhe dokumentacioni i dorëzuar grupeve etnike pakicë, si pjesë e konsultimeve, duhet të kryhet në një gjuhë të përshtatshme, të njohur si gjuhë zyrtare ose rajonale në Kosovë.</p> |
| Mekanizmi për ankesa | <p>Mekanizmi për ankesa specifik për projektin duhet të krijohet sa më shpejt që të jetë e mundur në proces, për të marrë dhe trajtuar në kohën e duhur shqetësimet specifike në lidhje me</p> | <p>Pronarët ose bartësit e interesit kanë të drejtë të parashtojnë ankesa në faza të ndryshme të procesit dhe të dorëzojnë komente me shkrim pranë autoritetit</p> | <p>Procedura për ankesa do të vendoset si pjesë e zbatimit të Planit për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) dhe do të përfshijë aspekte të blerjes së tokës.</p> |

| Çështja | Kërkesa e BERZH-it | Dispozita e Ligjit të Kosovës | Masat për mbyllje të hendekut |
|--------------------------------------|--|--|--|
| | kompensimin dhe relokimin që ngrihen nga personat e zhvendosur. | shpronësues gjatë procesit të konsultimit, por nuk ka kërkesë për një mekanizëm për ankesa specifik për projektin. | |
| Pjesëmarrja / konsultime kuptimplote | Konsultimi kuptimplotë i personave dhe komuniteteve të prekura, duke përfshirë komunitetet pritëse, do të organizohet nga klienti gjatë gjithë procesit të planifikimit dhe zbatimit të risistemimit. Përpjekjet e konsultimit dhe angazhimit duhet të mbështeten me dokumentacion të thjeshtë, praktik, të saktë dhe të përshtatshëm nga ana kulturore, të destinuar për shpërndarje të gjerë mes personave të prekur. | Disa nene të Ligjit përcaktojnë njoftimin/konsultimin me pronarët e pronave dhe palët e interesit. Megjithatë, Ligji nuk i merr parasysh nevojat e pakicave etnike dhe personave të zhvendosur. Ai gjithashtu nuk rregullon procedurën për trajtimin e pronarëve që mungojnë të pronave, si dhe nuk përmban asnjë masë për të siguruar të drejtat e pronarëve të tillë për t'u informuar në kohë dhe në mënyrën e duhur për çdo veprim administrativ të ndërmarrë kundër pronës së tyre dhe për mjete juridike efektive. | Përveç kërkesave për shpalosje të informacionit dhe konsultime të përcaktuara nga legjislacioni vendas, PBTRMJ do të përfshijë konsiderata të veçanta për nevojat e secilit grup etnik pakicë dhe të personave të zhvendosur për të siguruar ndarjen e duhur dhe në kohë të informacionit përmes PBTRMJ-së. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit adekuat të gjuhëve zyrtare gjatë shpalosjes së informacionit relevant. Në lidhje me pronarët që mungojnë të pronave, do të përdoren të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të identifikuar dhe gjetur në mënyrë të duhur pronarët që mungojnë të pronave, për të angazhuar ndihmën e zyrave të komuniteteve të pakicave dhe/ose organizatave joqeveritare në Kosovë nëse është e nevojshme, dhe për të depozituar shumën e kompensimit në një llogari të veçantë në Bankën Qendrore të Kosovës. |
| Monitorimi i zbatimit të PBTRMJ-së | Marrëveshjet për monitorimin e procesit të blerjes së tokës duhet të përcaktohen nga PBTRMJ. | Asnjë dispozitë | Monitorimi do të kryhet nga NJZP-ja. |

3 PARIMET KYÇE PËR BLERJE TË TOKËS

NJZP-ja ka marrë përsipër që në zbatimin e Projektit t'u përmbahet parimeve të mëposhtme në lidhje me blerjen e tokës dhe kufizimin e qasjes në pronë, të cilët do të mundësojnë pajtueshmërinë e plotë me të gjitha kërkesat e KP 5 të BERZH-it, dhe tejkalimin e të gjithë hendekëve të identifikuar mes këtyre kërkesave dhe legjislacionin kombëtar:

1. **Të gjitha blerjet e pavullnetshme të tokës ose kufizimi i qasjes në asete** do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe kërkesat e BERZH-it. Në rast të ndonjë mospërputhje ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe kërkesave të BERZH-it, do të përdoren standardet më të larta.
2. **Risistemimi i pavullnetshëm do të shmanget aty ku është e mundur, ose do të minimizohet**, duke eksploruar dizajne të tjera të mundshme alternative të projektit sipas nevojës gjatë zhvillimit të dokumentacionit të dizajnit. NJZP-ja do të bëjë përpjekje maksimale për të lidhur **marrëveshje të negociuara** me PPP-në në mënyrë që të shmanget shpronësimi. Përpjekje të tilla do të dokumentohen.
3. **Nga NJZP do të zhvillohet një PBTRMJ i detajuar** në përputhje me kërkesat e kësaj KBTRMJ. Zhvillimi i PBTRMJ-së do të përfshijë gjithashtu **anketën socio-ekonomike dhe regjistrimin**, që do të kryhen njëkohësisht, dhe që do të identifikojnë si përdoruesit formalë ashtu edhe joformalë të tokës/pronës, si dhe personat/familjet e cënueshme.

Është konstatuar se një numër i caktuar i pronarëve të lokacionit të ardhshëm të ITUZ-it i përkasin grupit etnik serb. Marrë parasysh situatën gjeopolitike të pranuar gjerësisht dhe mungesën e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, mund të ketë vështirësi në kontaktimin me këta pronarë të tokës. Ky shqetësim intensifikohet nëse vendbanimi i tyre aktual është në Serbi, duke e komplikuar apo edhe duke e bërë të pamundur komunikimin me ta. Prandaj, NJZP-ja do të duhet të identifikojë, para fillimit të zhvillimit të PBTRMJ-së, autoritetet kompetente shtetërore në Kosovë, OJQ-të dhe organizatat relevante ndërkombëtare (si OKB-ja, OSBE-ja etj.) të cilat mund të ndihmojnë në vendosjen e kontakteve me pronarët e përmendur të tokave. Pas identifikimit të këtyre pronarëve dhe kanaleve të komunikimit me ta, NJZP-ja do t'i përfshijë detajet në PBTRMJ.

PBTRMJ i detajuar do të përmbajë një matricë të përshtatur të të drejtave, aktivitetet e konsultimit, aranzhimet e zbatimit, listën e parcelave dhe përdoruesve të tokës të prekur, dhe planet për monitorimin dhe vlerësimin e çdo aktiviteti për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës. Është e rëndësishme që ky proces të zbatohet njëkohësisht me përgatitjen e dizajneve të detajuara për ITUZ-in.

Dimensionet specifike gjinore të zhvendosjes do të merren parasysh më tej në PBTRMJ gjatë anketës bazë, vlerësimit të ndikimit dhe proceseve të zbutjes dhe monitorimit.

Zhvillimi i PBTRMJ-së do të përfshijë identifikimin e ndikimeve të Projektit dhe personave të prekur, dhe do të përfshijë:

- a. **Hartëzimin e zonës së projektit dhe amvisërive/parcelave të tokës të prekura** duke përfshirë kategorinë e tokës, pronarët, çdo qiramarrës dhe modelet e përdorimit të tokës.
- b. **Regjistrimin e parcelave, aseteve dhe personave të prekur** për të krijuar një listë të personave me të drejta formale dhe joformale në tokë dhe mjete jetese të lidhura me tokën, si dhe për të identifikuar ata që do të kenë të drejtë për kompensim dhe/ose ndihmë, veçanërisht duke u kushtuar vëmendje personave/amvisërive të cënueshme, siç janë grupet etnike pakicë, nënat vetë-ushqyese, të vejat dhe vejanët, personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, ose ata që jetojnë në varfëri.

Regjistrimi i detajuar i të gjithë personave të prekur, amvisërive, parcelave, pronave dhe aseteve të tjera është i nevojshëm për të identifikuar numrin e personave dhe parcelave të prekura. Regjistrimi duhet të ndërmerret nga NJZP-ja ose një palë e tretë me përvojë në aktivitetet e regjistrimit dhe anketimit. Regjistrimi do të mbledhë informacion për identifikimin në kadastër dhe koordinatat e parcelave të tokës, asetat, kategorinë e tokës, madhësinë e

parcelës dhe çdo kulturë të kultivuar, drunj dhe strukturë që do të ndikohet nga Projekti. Regjistrimi do të përdorë informacionin kadastral për të identifikuar pronarët dhe shfrytëzuesit formalë të tokës. Mund të nevojiten hetime të mëtejshme në terren për të identifikuar pronarët dhe përdoruesit joformalë të parcelave të tokës të prekura.

Do të vendoset një datë e ndërprerjes për pranueshmërinë sipas kërkesave të BERZH-it dhe legjislacionit kombëtar. Informacioni në lidhje me datën e ndërprerjes do të publikohet gjerësisht në të gjithë zonën e prekur nga projekti.

c. **Anketën socio-ekonomike** për të plotësuar të dhënat e regjistrimit dhe për të mbledhur informacion të detajuar për sfondin socio-ekonomik të personave të prekur, si dhe për të vlerësuar ndikimet në mjetet e tyre të jetesës në mënyrë që të vendosen kompensime të drejta dhe masa për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës.

Anketa socio-ekonomike do të ofrojë informacion të detajuar për mjetet e jetesës, asetet, aktivitetet dhe strukturat formale dhe joformale. Të gjithë personat e prekur, pavarësisht nga titulli zyrtar, të cilët janë regjistruar gjatë regjistrimit, do të kenë të drejtë për kompensim në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BERZH-it siç përcaktohet në këtë KBTRMJ.

Anketa socio-ekonomike duhet të identifikojë gjithashtu: modelet e përdorimit të tokës, kulturat e kultivuara dhe përdorimin e burimeve natyrore; mjetet e jetesës dhe nivelet e të hyrave të personave të prekur, veçanërisht të hyrat nga toka e humbur përkohësisht dhe të hyrat për përdoruesit formalë dhe joformalë të tokës; dhe përdoruesit e burimeve sezonale që mund të ndikohen nga Projekti.

Matrica e të drejtave do të zhvillohet në PBTRMJ bazuar në informacionin nga hapat e mësipërm dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BERZH-it. Matrica do të përshkruajë grupet e personave të prekur dhe ndihmën, kompensimin dhe rimëkëmbjen e mjeteve të jetesës që u takon.

4. **Të gjithë personat e prekur do të informohen, konsultohen në mënyrë domethënëse dhe do të inkurajohen të marrin pjesë** në përgatitjen e PBTRMJ-së dhe gjatë të gjithë procesit të blerjes së tokës, në përputhje me kërkesat për shpallje të informacionit dhe konsultime të përcaktuara në këtë KBTRMJ. Procesi i konsultimit do të sigurojë që të merren parasysh këndvështrimet e grave dhe interesat e tyre të përfshihen në të gjitha aspektet e planifikimit dhe zbatimit të risistemimit. Do të eksplorojnë dhe dokumentohen preferencat e grave dhe burave për sa i përket mekanizmave të kompensimit, tokës zëvendësuese ose qasje alternative në asete në vend të parave të gatshme. Do të merren masa për të siguruar pjesëmarrje domethënëse të grave dhe burave në çdo konsultim rreth risistemimit, duke përfshirë oraret e përshtatshme të takimeve, transportin, mbështetjen e kujdesit për fëmijët, si dhe thirrjen e takimeve vetëm për gratë kur është e nevojshme.

5. **Datat e ndërprerjes** të përcaktuara në legjislacionin vendas (dhe që do të specifikohen në PBTRMJ) do të përdoren në kombinim me datën e regjistrimit dhe inventarit të aseteve si datë e ndërprerjes për personat pa ndonjë të drejtë të njohur, nëse gjenden kategori të tilla.

Secili person që vendoset në zonën e Projektit pas datës së ndërprerjes nuk do të jetë i pranueshëm për asnjë kompensim, por do t'i jepet një njoftim paraprak i mjaftueshëm, do t'i kërkohej të lirojë ambientet dhe të çmontojë strukturat e prekura (nëse ka) përpara zbatimit të Projektit.

6. **Vlerësimi i të gjitha aseteve** që janë objekt kompensimi, duke përfshirë çdo ndërtesë, kulturë bujqësore, aktivitete ekonomike të ndërprera dhe qasje në burimet natyrore, do të bëhet nga vlerësues të certifikuar të caktuar. Procedura e vlerësimit do të ndërmerret në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe kërkesat e BERZH-it. Për të arritur vlerën e plotë të zëvendësimit, vlerës së tregut do t'i shtohen kostot e transaksionit që lidhen me rimëkëmbjen e tokës dhe aseteve, të tilla si taksat dhe tarifat e regjistrimit, dhe vlera e përmirësimeve të tokës. Shpenzimet e relokimit do të paguhen nëse nevojitet ndonjë relokim.

Do të vendosen dispozita për të mundësuar korrjen e të kulturave përpara hyrjes në tokë. Kulturat vjetore që janë korrur para hyrjes në tokë nuk do të kompensohen. Normat e kompensimit për kulturat e mbetura do të llogariten në bazë të vlerës së zëvendësimit duke

marrë parasysh produktivitetin e tokës bazuar në rendimentin vjetor të vlerësuar të kulturës për hektar shumëzuar me çmimin e tregut të kulturës. Kur pronarëve të tokës të prekur nuk mund t'u ofrohet prona me zëvendësim të plotë, në paketën e kompensimit do të përfshihet ndihma për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës.

Në rastet kur ndodh shpronësimi i pjesshëm i tokës bujqësore dhe toka e mbetur vlerësohet nga pronari i tokës si e papërshtatshme për përdorim të mëtejshëm bujqësor, do të merret parasysh kompensimi për vlerën e parcelës së plotë të tokës.

7. Të gjithë pronarët dhe përdoruesit e pronës së prekur në kohën e datës së ndërprerjes, qoftë me ose pa të drejta pronësie të njohura plotësisht, janë të pranueshëm për kompensim dhe/ose ndihmë, siç përshkruhet në Matricën e të Drejtave. E drejta për kompensim dhe rimëkëmbje të mjeteve të jetesës do të shtrihet tek personat e prekur të cilët nuk kanë të drejta ligjore të njohura ose pretendojnë tokën që e përdorin për mjetet e tyre të jetesës, të cilët do të identifikohen përmes regjistrimit gjatë përgatitjes së PBTRMJ-së. **Kompensimi do të kryhet gjithmonë përpara hyrjes në tokë ose marrjes në posedim të pronës** nga përfituesi i shpronësimit. Çështjet në lidhje me pagesën e kompensimit në para të gatshme do të diskutohen dhe dakordohen me pronarët dhe të gjithë anëtarët e prekur të amvisërive. Kompensimi në para të gatshme do të paguhet plotësisht ose me këste siç dakordohet me pronarët dhe anëtarët e prekur të amvisërive dhe siç përcaktohet në kontrata, në llogaritë bankare të specifikuara nga pronarët, me marrëveshje të të gjithë anëtarëve të prekur të amvisërisë. Në rastet kur ka më shumë se një pronar të pronës (d.m.th. bashkëpronësi e çifteve të martuara), shumat e kompensimit do të ndahen dhe do të paguhen në llogaritë bankare që ata specifikojnë.

Në rastin e **pronarëve që mungojnë** (p.sh, personat me të drejta të ligjshme në tokë, por që jetojnë diku tjetër), edhe ata do të jenë të pranueshëm për kompensim dhe NJZP-ja do të bëjë dhe dokumentojë përpjekjet e veta për t'i gjetur ata dhe për t'i informuar për procesin. Nëse ata nuk mund të gjenden, në përputhje me kërkesat lokale, shumat e kompensimit duhet të ndahet në një llogari të ruajtjes dhe të jetë lehtësisht e disponueshme nëse rishfaqet pronari që mungon.

Në rast se ka ndonjë **çështje ligjore në lidhje me pronësinë** e një prone, shumat e kompensimit duhet të ndahet në një llogari të ruajtjes dhe të jetë e disponueshme pasi të jenë zgjidhur çështjet ligjore që lidhen me pronësinë.

Pagesa e kompensimit do të bëhet nga Ministria e Financave përpara blerjes së tokës ose humbjes së qasjes në aktivitetet ekonomike dhe burimet natyrore, në llogaritë bankare të specifikuara nga pronarët/përdoruesit, me marrëveshje të të gjithë anëtarëve të prekur të amvisërisë.

8. Do të vendoset një **mekanizëm efektiv për ankesa** për marrjen dhe adresimin në kohë të çdo shqetësimi në lidhje me Projektin, përfshirë çështjet e mbuluara në këtë KBTRMJ.
9. NJZP-ja do të **monitorojë zbatimin e proceseve të blerjes së tokës dhe risistemimit** përmes aranzhimeve zyrtare institucionale në mënyrën e përshkruar më hollësisht në këtë KBTRMJ.

4 PRANUESHMËRIA DHE TË DREJTAT

Matricë paraprake e të Drejtave është paraqitur më poshtë për të përcaktuar parimet e kompensimit për grupe të ndryshme të personave të prekur në varësi të aseteve, pronave dhe humbjes së mjeteve të jetesës si rezultat i Projektit.

Kjo Matricë e të Drejtave do të duhet të përditësohet dhe të përshtatet për blerjen e tokës të identifikuar dhe personat e prekur ekonomikisht si pjesë e PBTRMJ-së.

Tabela 4-1: Matrica e të Drejtave

| Lloji i humbjes/ndikimit të mundshëm | Kategoria e personit/subjektit të prekur | Të Drejtat |
|---|---|--|
| Humbje e përhershme e tokës në pronësi ose përdorim privat | Pronarët e tokës | Kompensim në para të gatshme për asetet e humbura me kosto të plotë zëvendësimi ose përmes tokës zëvendësuese të barabartë në vlerë dhe produktivitet me parcelën e humbur, dhe në lokacione të pranueshme për personat e prekur aty ku është e mundur. Do të blihet edhe çdo tokë e identifikuar ekonomikisht e paqëndrueshme – jetime, nëse kërkohet nga pronari dhe përcaktohet si e paqëndrueshme, nga vlerësues të certifikuar. |
| | Çdo përdorues joformal i tokës | Sigurim i informacionit nga NJZP-ja për blerjen e tokës të paktën tre muaj përpara fillimit të punimeve të ndërtimit në tokë për t'i lejuar personit që e përdor tokën në mënyrë joformale të gjejë një alternativë dhe ta lirojë tokën e prekur nga projekti, ndihmë në gjetjen e një opsion alternativ dhe kompensim për çdo aset dhe kulturë bujqësore në tokë (<i>shih pikat e veçantë për kulturat vjetore, drunjtë pyjorë dhe çdo përmirësim në tokë më poshtë</i>). |
| Humbje e përhershme e qasjes në tokë publike për bujqësi | Qiramarrës afatgjatë | Zëvendësim me tokë publike me të njëjtën madhësi dhe cilësi për përdorim ose rishikimi i kontratës ekzistuese për të pasqyruar sipërfaqen e reduktuar të tokës në dispozicion për përdorim. Kompensim me koston e plotë të zëvendësimit i çdo dëmtimi ose humbje të pësuar nga përdoruesi i prekur i tokës. |
| | Përdorues informal i tokës | Në rast të plotësimit të ndonjërit prej kriterëve të cënueshmërisë që do të përcaktohen në PBTRMJ-në e ardhshëm, do të ofrohet ndihmë specifike për cënueshmërinë (përveç ndihmës për gjetjen e një opsioni alternativ siç theksohet në pikën e mësipërme) |
| Humbje e kulturave vjetore ose bimëve (përfshirë humbjet që rrjedhin nga kufizimet e përdorimit të tokës) | Pronari i kulturave (mund të jetë pronar i tokës, qiramarrës ose përdorues joformal i tokës) | E drejta për korrije të kulturave. OSE Kompensim në para të gatshme për kulturat vjetore të humbura, me kosto të plotë zëvendësimi, siç përcaktohet nga vlerësuesit e certifikuar. |
| Humbja e drunjve frutorë/vreshtave (përfshirë humbjet që rrjedhin nga kufizimet e përdorimit të tokës) | Pronar i drunjve frutorë/vreshtave (mund të jetë pronar i tokës, qiramarrës ose përdorues joformal i tokës) | Kompensimi në para ta gatshme për rendimentet e humbura shumëvjeçare dhe lëndën drusore (nëse është e aplikueshme), me kosto të plotë zëvendësimi, siç përcaktohet nga vlerësuesit e certifikuar. |

| Lloji i humbjes/ndikimit të mundshëm | Kategoria e personit/subjektit të prekur | Të Drejtat |
|---|--|--|
| Humbje e drunjve pyjorë (përfshirë humbjet që rrjedhin nga kufizimet e përdorimit të tokës) | Pronar i drunjve pyjorë | Kompensim në para të gatshme për humbjen e drunjve pyjorë, me kosto të plotë zëvendësimi, siç përcaktohet nga vlerësuesit e certifikuar. |
| Humbje e çdo përmirësimi të bërë në tokë (p.sh. sistemi i ujitjes, pusi i ujit) | Pronari i përmirësimeve (mund të jetë pronar i tokës, qiramarrës ose përdorues joformal i tokës) | Kompensim në para të gatshme për përmirësimet me kosto të plotë zëvendësimi, siç përcaktohet nga vlerësues të certifikuar. DHE E drejta për të hequr dhe marrë me vete çdo përmirësim të lëvizshëm të bërë në tokë. |
| Humbje e të hyrave ose e mjeteve të jetesës e lidhur me njërin nga humbjet e mësipërme (zhvendosje ekonomike) | Të gjitha kategoritë e personave të prekur të renditur më sipër | Ndihmë e përshtatur individualisht për rimëkëmbjen ose përmirësimin e mjeteve të jetesës (p.sh. ndihmë për qasje në punësim në Projekt ose përmes departamenteve sociale komunale, ndihmë për qasje në toka të tjera për përdorim, ndihmë për qasje në programet bujqësore në dispozicion, etj.) |
| Ndikim joproporcional/më i vështirë, si rezultat i cenueshmërisë | Individë/amvisëri të cenueshme | Ndihmë e përshtatur individualisht (ndihmë për marrjen e dokumenteve të nevojshme personale, ndihmë për hapjen e një llogarie bankare, ndihmë për qasje në programet e mirëqenies sociale ose shëndetësore të ofruara në komunë, mbështetje juridike dhe ndihmë për formulimin e ankesave, etj.) |
| Ndikim i papërcaktuar (humbje e përhershme ose e përkohshme) | Të gjitha kategoritë | Çdo ndikim i padefinuar do të zbutet në përputhje me parimet dhe objektivat e kësaj KBTRMJ. |

5 SHPALOSJA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMET

Shpalosja e KBTRMJ-së

Kërkesat për shpalosjen e dokumenteve të projektit (përfshirë këtë KBTRMJ) dhe konsultimet publike janë përcaktuar në Planin për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) të përgatitur për këtë Projekt, në kuadër të Paketës së Shpalosjes së Projektit, me qëllim të rritjes së angazhimit të palëve të interesit gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit dhe kryerjes së angazhimit të palëve të interesit në përputhje me kërkesat e legjislacionit lokal dhe kërkesat e BERZH-it.

KBTRMJ do të mbetet në domenin publik për të gjithë kohëzgjatjen e ciklit të Projektit. Ajo do të jetë e disponueshme publikisht në shqip, serbisht dhe anglisht në formë elektronike dhe të shtypur në:

| Emri i institucionit | Ueb faqja | Adresa | Shënim |
|----------------------|---|---|---|
| KRUB | http://www.bifurkacioni.com/ | Rr. Enver Topalli, Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)290 320 650 info@bifurkacioni.com | Seksioni i ueb faqes me dokumentet e publikuara të Projektit do të rifreskohet të paktën një herë në vit për të siguruar dukshmërinë e dokumenteve. |
| Komuna e Ferizajt | https://kk.rks-gov.net/ferizaj/ | Rr. Dëshmorët e Kombit, p.n., Ferizaj, Kosovë Tel. +383 (0)38 200 46 076 & 080011005 info.ferizaj@rks-gov.net | - |
| Komuna e Kaçanikut | https://kk.rks-gov.net/kacanik/ | Rr. Emin Duraku, Kaçanik, Kosovë Tel. +383 290 380 047 & 080011014 | - |

Shpalosja dhe konsultimet gjatë zhvillimit të ardhshëm të PBTRMJ-së

PBTRMJ do të zhvillohet në komunikim të ngushtë me komunitetet e prekura. Personave të prekur do t'u ofrohen mundësi të diskutojnë qasjen ndaj kompensimit dhe rimëkëmbjes së mjeteve të jetesës, si dhe të bëjnë çdo pyetje që mund të kenë në lidhje me proceset. Draft PBTRMJ do të publikohet dhe personat e prekur nga projekti do të inkurajohen ta shprehin mendimin e tyre dhe të japin komente në lidhje me Projektin, si dhe të propozojnë zgjidhje specifike për çështje që lindin. Të gjitha komentet dhe propozimet e garantuara do të marrin vëmendjen e duhur. Kërkesat specifike për shpalosjen dhe konsultimin do të përcaktohen në PBTRMJ. PBTRMJ do të përfshijë konsiderata të veçanta për nevojat e çdo grupi etnik pakicë dhe të personave të zhvendosur për të siguruar ndarjen e duhur dhe në kohë të informacionit përmes PBTRMJ-së. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përdorimit adekuat të gjuhëve zyrtare gjatë shpalosjes së informacionit relevant.

Siç u përmend më herët, NJZP-ja do të duhet të identifikojë, para fillimit të zhvillimit të PBTRMJ-së, autoritetet kompetente shtetërore në Kosovë, OJQ-të dhe organizatat relevante ndërkombëtare (si OKB-ja, OSBE-ja etj.) të cilat mund të ndihmojnë në vendosjen e kontakteve me pronarët e tokave që i përkasin ndaj grupit etnik serb. Pas identifikimit të këtyre pronarëve dhe kanaleve të komunikimit me ta, NJZP-ja do t'i përfshijë detajet në PBTRMJ.

6 ARANZHIMET E ZBATIMIT

Rolet dhe përgjegjësitë

NJZP-ja do të zhvillojë PBTRMJ ose do të angazhojë specialistë të kualifikuar të risistemimit për ta zhvilluar PBTRMJ-në. NJZP-ja do të jetë përgjegjëse për zbatimin e të gjitha aspekteve të KBTRMJ/PBTRMJ dhe do të bashkëpunojë me të gjitha autoritetet dhe organizatat e nevojshme. Palëve të përfshira në aspekte të ndryshme të zbatimit të projektit do t'u kërkohej të përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë KBTRMJ.

Zbatimi i PBTRMJ-së do të fillojë përpara aktiviteteve të ndërtimit. Përgjithësisht, zbatimi i PBTRMJ-së do të ketë tri faza kryesore:

- Takimet publike, regjistrimi dhe anketa socio-ekonomike dhe procesi i negociatave në lidhje me posedimin/përdorimin e përkohshëm të tokës.
- Sigurimi i të drejtave në tokë, pagesa e kompensimit dhe rimëkëmbja e mjeteve të jetesës.
- Procesi i monitorimit dhe raportimit të zbatimit të PBTRMJ-së tek BERZH-i.

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Nga NJZP-ja do të ndërmerren monitorimi i vazhdueshëm, vlerësimi dhe raportimi periodik për zbatimin e PBTRMJ-së. NJZP-ja do të mbajë një bazë të të dhënave për blerjen e tokës. Të dhënat/informatat do të përditësohen periodikisht. Të gjitha informacionet për personat e prekur nga Projekti, pronat e tyre dhe pagesat për kompensimin e tyre dhe masat e ndihmës do të mbahen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (Bashkimi Evropian, 2016) dhe Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Monitorimi do të kryhet për të përcjellë progresin, për të identifikuar problemet dhe për të bërë ndryshime aty ku është e nevojshme. Si rregull i përgjithshëm, ai do të përfshijë treguesit e mëposhtëm specifikë (siç mund të ndryshohen në PBTRMJ bazuar në informacionin më specifik të mbledhur gjatë zhvillimit të PBTRMJ-së):

| |
|---|
| Treguesit e inputeve (<i>monitorim i progresit për të matur nëse aktivitetet janë kryer siç specifikohet në PBTRMJ</i>) |
| <ul style="list-style-type: none"> • Shpenzimet e përgjithshme për shpronësim dhe kompensim • Kompensimi i paguar në llogaritë e ruajtjes • Numri i personave të prekur sipas kategorive (në përputhje me kategoritë në Matricën e të Drejtave) • Numri i personave të prekur që u përkasin grupeve të cënueshme (veçanërisht grupet etnike pakicë) |
| Treguesit e outputeve (<i>monitorim i performancës për të matur rezultatet e inputeve që janë realizuar</i>) |
| <ul style="list-style-type: none"> • Numri i takimeve publike dhe konsultimeve domethënëse me personat e prekur • Numri i personave që kanë marrë kompensim • Numri dhe përqindja e marrëveshjeve të negociuara të nënshkruara dhe numri i marrëveshjeve individuale të kompensimit • Numri i personave që kërkojnë ndihmë të veçantë (si mbështetja ligjore) dhe llojet e ndihmës së ofruar në kohën e duhur • Numri dhe shuma e pagesave që rimëkëmbin humbjen e të hyrave • Dokumentimi i përpjekjeve për të komunikuar me grupet e cënueshme (veçanërisht grupet etnike pakicë) |
| Treguesit e rrjedhëve (<i>vlerësimi i ndikimit për të matur nëse realizimi i inputeve dhe arritja e outputeve po kontribuojnë në përmbushjen e suksesshme të objektivave që janë vendosur për zbatimin e PBTRMJ-së</i>) |

| |
|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Numri dhe lloji i ankesave, duke përfshirë çdo çështje gjyqësore, në lidhje me blerjen e tokës; përqindja e ankesave të zgjidhura në formë të kënaqshme për palët e prekura; koha mesatare e përpunimit; çfarëdo trendi |
| <ul style="list-style-type: none"> • Koha mesatare për pagesën e kompensimit |
| <ul style="list-style-type: none"> • Llojet e ndihmës së posaçme të ofruar në kohën e duhur |
| <ul style="list-style-type: none"> • Pagesa e kompensimit me koston e plotë të zëvendësimit |
| <ul style="list-style-type: none"> • Kënaqshmëria me pagesën e kompensimit |
| <ul style="list-style-type: none"> • Rivendosja e të hyrave/mjeteve të jetesës |

NJZP-ja do të përfshijë në raportimin e vet tremujor të dhënat e monitorimit dhe raportimin për progresin në aktivitetet e PBTRMJ-së gjatë procesit të blerjes së tokës, si dhe do të përmbledhë informacionin përkatës në raportet e vet për BERZH-in.

Kur të ketë përfunduar e gjithë blerja e tokës dhe të gjitha ndikimet të zbuten me sukses, do të zhvillohet një **Raport përfundimtar për Ekzekutimin e Blerjes së Tokës dhe Risistemimin** i cili do t'i dorëzohet BERZH-it. Raporti do të përfshijë: një përmbledhje të ndikimeve dhe parimeve të projektit që drejtojnë PBTRMJ-në; përshkrimin e përpjekjeve për të shmangur dhe minimizuar zhvendosjen; përmbledhjen e eventeve dhe rezultateve të konsultimit, duke përfshirë mënyrën si ndikuan ato në të drejtat dhe veçoritë e tjera të aktiviteteve të blerjes së tokës, risistemimit dhe rimëkëmbjes së mjeteve të jetesës; përshkrimin e procesit të dorëzimit të kompensimit; përshkrimin e çdo problemi të hasur dhe mënyrën si janë zgjidhur ato; përmbledhjen e ankesave të pranuar dhe mënyrën si janë zgjidhur ato, duke përfshirë listën e çdo ankese dhe lëndë gjyqësore në gjykim në datën e dorëzimit të raportit; përshkrimin e burimeve të mobilizuara për të planifikuar dhe zbatuar aktivitetet e blerjes së tokës, risistemimit dhe rimëkëmbjes së mjeteve të jetesës.

NJZP-ja do të sigurojë gjithashtu që të kryhet një **auditim i jashtëm i përfundimit** nga specialistë të pavarur të kualifikuar dhe kompetentë për risistemimin pasi të kenë përfunduar të gjitha aktivitetet e blerjes së tokës dhe rezultatet e tyre të mund të maten. Raporti i përfundimit ka objektivat e mëposhtme:

- të vlerësohet efektshmëria e masave për të shmangur dhe minimizuar ndikimet e zhvendosjes,
- të verifikohen që janë realizuar të gjitha të drejtat dhe zotimet e përshkruara në PBTRMJ,
- të përcaktohet nëse masat për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës kanë qenë efektive në rimëkëmbjen ose rritjen e standardeve të jetesës dhe mjeteve të jetesës së personave të prekur,
- të kontrollohet secila ankesë që mund të ketë mbetur e pazgjidhur.

Raporti i auditimit të përfundimit do të paraqesë konkluzione për efektshmërinë e zbatimit të zotimeve të PBTRMJ-së, si dhe do të identifikojë çdo masë korigjuese që mund të jetë e nevojshme. BERZH-i mund t'i kërkojë NJZP-së ta shpallë raportin e auditimit të përfundimit.

Kostot dhe kalendari

Buxheti i detajuar dhe afati kohor për zbatimin do të përcaktohen në PBTRMJ përpara fillimit të secilit aktivitet për blerje të tokës. Buxheti do të mbulojë kompensimin, çdo kosto për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe shpenzimet e paparashikuara dhe administrative.

7 MEKANIZMI PËR ANKESA

Për të mbledhur reagime, pyetje dhe komente në lidhje me këtë KBTRMJ dhe PBTRMJ-në e ardhshëm, do të përdoret një mekanizëm për ankesa i krijuar sipas Planit për Angazhim të Palëve të Interesit. Do të vendoset në fillim të procesit për t'i marrë dhe adresuar në kohën e duhur komentet dhe pyetjet e palëve të interesit, si dhe për të ofruar informata të mëtejshme për kompensimin dhe masat për rimëkëmbje të mjeteve të jetesës për personat e prekur nga zhvendosja fizike ose ekonomike. Ankesat

do të adresohen në kohën e duhur sipas mekanizmit për ankesa të paraqitur në Planin për Angazhim të Palëve të Interesit.